


TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

Korrik 2026


Në Korrik 2026 eksportet e mallrave arritën vlerën 33,7 mld lekë, duke u rritur me 10,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 5,0 %, në krahasim me Qershor 2026. Importet e mallrave arritën vlerën 86,4 mld lekë, duke u rritur me 3,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 3,5 %, në krahasim me Qershor 2026. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 52,8 mld lekë, duke u ulur me 0,5 %, krahasuar me një vit më parë dhe duke u rritur me 9,8 %, në krahasim me Qershor 2026.

FIG. 1 TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS MUAJVE, NË MILIARD LEKË




Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve

Gjatë muajit Korrik 2026, në rritjen e eksporteve prej 10,6 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me +8,9 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +5,3 pikë përqindje, "Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +0,9 pikë përqindje, ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: "Tekstile dhe këpucë" me -4,3 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me -0,6 pikë përqindje, etj. (Fig. 2)

FIG.2 KONTRIBUTI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR TË EKSPORTEVE, KORRIK 2026 (%)

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve

Gjatë muajit Korrik 2026, në rritjen e importeve prej 3,6 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar pozitivisht grupet: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +1,5 pikë përqindje, "Ushqime, pije, duhan" me +0,8 pikë përqindje dhe "Materiale ndërtimi dhe metale" me +0,3 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: "Lëkurë dhe artikujt prej tyre" me -0,02 pikë përqindje dhe "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me -0,01 pikë përqindje. (Fig. 3)

FIG.3 KONTRIBUTI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR TË IMPORTEVE, KORRIK 2026 (%)

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Korrik 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2025 janë: Greqia (19,0 %), Gjermania (2,5 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rënien më të madhe, janë: Italia (2,0 %), Kosova (2,4 %), etj.

Në muajin Korrik 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2025 janë: Italia (0,3 %), Kina (22,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rënien më të madhe, janë: Greqia (2,9 %), Gjermania (9,2 %), etj.

Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 53,6 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2026, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 47,8 % të importeve gjithsej.

TAB. 1 QARKULLIMI I MALLRAVE, KORRIK 2026

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		367	35,0	784	29,6	-423	46,0
2022		481	30,9	950	21,2	-464	51,2
2023		430	-10,4	873	-8,2	-432	50,5
2024		369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2025		346	-6,1	887	-0,8	-541	39,0
2025	01-25	28	-4,5	60	0,1	-32	46,4
	02-25	30	-5,3	68	-8,6	-37	44,6
	03-25	31	-4,9	74	-1,4	-42	42,5
	04-25	30	-13,3	76	0,5	-46	39,5
	05-25	32	-7,9	78	-2,1	-46	41,0
	06-25	31	-9,0	77	-0,2	-45	40,8
	07-25	30	-6,9	83	-2,4	-53	36,5
	08-25	20	-8,4	67	-2,7	-47	30,1
	09-25	27	-10,7	75	5,6	-48	36,3
	10-25	31	1,0	80	3,6	-49	39,1
	11-25	28	-6,9	71	-3,0	-43	39,5
	12-25	27	5,6	80	1,3	-53	33,6
Jan-Dhj		346	-6,1	887	-0,8	-541	39,0
2026	01-26	27	-4,5	58	-4,0	-31	46,2
	02-26	31	2,8	68	0,8	-37	45,5
	03-26	33	4,1	80	9,0	-48	40,6
	04-26	35	16,9	79	4,4	-44	44,2
	05-26	33	2,9	81	4,2	-48	40,4
	06-26	35	13,6	83	9,1	-48	42,5
	07-26	34	10,6	86	3,6	-53	39,0

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Tregtia e Jashtme](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtitimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtitimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtitimit-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Njoftim i rëndësishëm për përdoruesit

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv. Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor. Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifën doganore.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësies matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri